VENDIM
Nr.124, datë 31.10.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIME DHE SHTESA NË KONTRATËN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTIN E KATEGORISË FAMILJARE

Në mbështetje të neneve 9, dhe 44, pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 18, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2008, pasi shqyrtoi propozimin për ndryshime dhe shtesa në kontratën e furnizimit me energji elektrike për klientët e kategorisë familjare,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.40, datë 31.8.2005 kontrata e furnizimit me energji elektrike për kategorinë e konsumatorëve familjarë.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta